



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

[Datë: 18/12/2020]

OPERATORIT EKONOMIK “BESNIK MEÇI” person fizik
KASHAR, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5, Godine nje katëshe perballe QTU-së

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim” në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 30 si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar) kreu IV, Neni 33.

Referenca e procedurës: **Loti i parë: REF-76977-10-28-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: **Loti I: ”Pjesë këmbimi goma”**

Fondi limit, Loti i parë: 5.114.366 (pesë milion e njëqind e katërbëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

Afati per realizimin e furnizimit: Operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe specifikimeve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor brenda 30 ditëve pune nga data e lidhjes së kontratës. Malli duhet të dorëzohet në magazinën e Bashkisë Tiranë.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 04.12.2020

Publikime të mëparshme, (nëse zbatohet): Buletini Nr. 94 datë 2 Nëntor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesit ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “Besnik Meçi” Pf,

NIPT L12407012R

Vlera e ofertes pa tvsh: 4.496.400 (katër milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë

Vlera e ofertës me tvsh: 5.395.680 (pesë milion e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë

2. Operatori ekonomik “R & R Group” sh.p.k

NIPT K81415001A

Vlera e ofertes pa tvsh: 3.926.000 (tre milion e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh: 4.711.200 (kater milion e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë

3. Operatori ekonomik “Auto Star Albania ” sha

NIPT J62023007G

Vlera e ofertes pa tvsh: 4.799.900 (katër milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind) lekë

Vlera e ofertës me tvsh: 5.759.880 (pesë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë.

Janë s’kualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “Auto Star Albania sha për arsyet si më poshtë vijon:

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë në kriteret e vecanta për kualifikim në rubrikën “Kapaciteti teknik” pika 2.3.11 ka përcaktuar se:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë AK, Bashkisë Tiranë, brenda afatit përfundimtar për pranimin e dorëzimit të ofertave një mostër për artikuajt goma me nr. Rendor 1 - 13 (referuar zërave në preventiv) në të kundërt bëhet shkak s’kualifikimi”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në dt. 04.12.2020 ora 12.00 që përkon me ditën dhe orën e hapjes së ofertave, konstatoi se Operatori ekonomik “Auto Star Albania” sha nuk ka paraqitur mostrat sipas artikuljeve me numër rendor nga 1-13 të përcaktuar në preventivin e vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë per lotin e parë “.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas konstatimit të **mosparaqitjes së mostrave konform përcaktimit të bërë në kriterin sa më sipërcituar**, vendosi ta shpallë të pavlefshme ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Star Albania sha” për lotin e parë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit duke mos i hyrë shqyrtimit të dokumentacionit tjetër të paraqitur nga kjo shoqëri për ekonomi të procedurës si edhe për vetë faktin se mosparaqitja e mostrave është kusht për s’kualifikim.

2. Operatori ekonomik “R & R Group” sh.p.k, NIPT K81415001A

Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë në kriteret e vecanta për kualifikim në rubrikën “Kapaciteti teknik” pika 2.3.11 ka përcaktuar se:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë AK, Bashkisë Tiranë, brenda afatit përfundimtar për pranimin e dorëzimit të ofertave një mostër për artikuajt goma me nr. Rendor 1 - 13 (referuar zërave në preventiv) në të kundërt bëhet shkak s’kualifikimi”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në dt. 04.12.2020 ora 12.00 që përkon me ditën dhe orën e hapjes së ofertave, konstatoi se Operatori ekonomik **R & R Group shpk** nuk ka paraqitur mostrat sipas artikuljeve me numër rendor nga 1-13 të përcaktuar në preventivin e vënë në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë per lotin e parë “.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas konstatimit të **mosparaqitjes së mostrave konform përcaktimit të bërë në kriterin sa më sipërcituar**, vendosi ta shpallë të pavlefshme ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik **R & R Group shpk** për lotin e parë, pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit duke mos i hyrë shqyrtimit të

dokumentacionit tjetër të paraqitur nga kjo shoqëri për ekonomi të procedurës si edhe për vetë faktin se mosparaqitja e mostrave është kusht për s'kualifikim

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik "Besnik Meçi" pf, Emri Tregtar: DBD GROUP, me adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, km 5, godinë njëkatëshe përballë QTU-së Kashar Tiranë, oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 4.496.400 (katër milion e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë pa tvsh dhe 5.395.680 (pesë milion e treqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lekë me tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranës sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet sic parashikon Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.12.2020

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.